Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0586

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Isa Hasani-kryetarë, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " Limit L & B SH.P.K", kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA E MAMUSHËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Shtruarja e dyshemesë me epoksid dhe ndërtimi i kartotekes në objektin e ri të QKMF-s në KK Mamushë me numër të prokurimit 626-23-5792-5-2-1, me 01/12/2023, mori:

Vendim

1. Miratohet**,** si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Limit L & B SH.P.K"- Prishtinë me nr. 2023/0586, e datës 14/08/2023, kurse vendimi i AK Komuna e Mamushës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shtruarja e dyshemesë me epoksid dhe ndërtimi i kartotekës në objektin e ri të QKMF-së në" KK Mamushë, me nr. të prokurimit: 626-23-5792-5-2-1, dhe Vendimi i AK-së për dhënie të kontratës mbetet në fuqi.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore në llogarinë e Operatorit Ekonomik " Limit L & B SH.P.K."- Prishtinë, sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 09.06.2023 Komuna e Mamushës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shtruarja e dyshemesë me epoksid dhe ndërtimi i kartotekës ne objektin e ri te QKMF-s ne KK Mamushe". Me datën 25.07.2023 është publikuar B58, Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "Eko Term Sh.p.k".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 23.961.75€.

Me 31.07.2023 OE "Limit L & B SH.P.K"- Prishtinë ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 02.08.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 14.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Limit L & B SH.P.K"- Prishtinë me nr. 586/23 për lidhur me aktivitetin "Shtruarja e dyshemesë me epoksid dhe ndërtimi i kartotekës ne objektin e ri te QKMF-s ne KK Mamushë" me nr. të prokurimit: 626-23-5792-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Operatori ekonomik ankues "Limit L & B SH.P.K."- Prishtinë konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56, 59, 60, 69 LPP-së, duke propozuar OSHP-së që ankesën të e aprovoj si të bazuar dhe lëndën ta kthej në Rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, Paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 16.08.2023 ka autorizuar Ekspertin Shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 586/23, ndërsa me datë 26.08.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0586 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar pjesërisht, ndërsa vendimi i AK-së të mbetet në fuqi."

-Pretendimet ankimore të OE "Limit L & B SH.P.K"-

Eksperti shqyrtues sa i përket pretendimit ankimor, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është i pa përgjegjshëm, pasi që i njëjti nuk ka prezantuar dëshmi për projektet e kërkuar nga AK. Eksperti vrenë Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës sipas dokumenteve të dorëzuara në dosjen e tenderit/ ofertës, rezulton që operatori ekonomik i rekomanduar "Eko Term Sh.p.k" ka të prezantuar listën e projekteve së bashku me dëshmi tjera dokumentare përmes të cilave vërtetohet se i njëjti e mbulon kërkesën kualifikuese.

Eksperti shqyrtues sa i përket pretendimit tjetër ankimor se OE i rekomanduar ankues në ankese po ashtu potencon se OE i rekomanduar" Eko Term Sh.p.k" ,për dhënie te kontratës, nuk ka prezantuar dëshmi sipas natyrës së kontratës, konstatohet se dosja e tenderit dhe në njoftim për kontrate është përcaktuar se kërkohet dëshmi për projekte të ngjashme dhe jo të njëjta, andaj dhe kx pretendim ankimor është i pabazuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimet ankimore kane te bëjnë kundër arsyetimit të eliminimit të ofertës së OE ankues, ku AK/ Komuna Mamushe, sipas letrës standarde ka potencuar se , Sigurimi i Tenderit i prezantuar nuk i plotëson kërkesën kualifikuese, përkatësisht periudhën e kërkuar prej 90 dite. Ankuesi në ofertën e tij ka prezantuar, Sigurimin e Tenderit me validitet nga Kompania e Sigurimeve Sigal, ne vlere prej 1,000.00 Euro, për periudhën kohore nga data 03.07.2023 deri me date 30.09.2023. Sipas datave të përshkruara rezulton që e mbulon periudhën kohore të kërkuara prej 90 ditësh, pasi qe hapja e ofertave është bere me datën 03.07.2023, datë kjo kur fillon dhe numërohet si garancion për sigurim te tenderit, prandaj këtë pretendim ankimor e konsiderojmë si të bazuar.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimore se OE i rekomanduar nuk posedon furnizim me epoksid, Eksperti sqaron se AK Komuna Mamushe, nuk ka kërkuar kontrata te furnizimeve të tilla, prandaj ketë pretendim ankimor e kualifikojmë si te pa bazuar.

Eksperti shqyrtues si përfundim sqaron se, sipas procesverbalit të hapjes së ofertave, OE ankues ka ofertuar me çmim me të larte se ai i rekomanduar për dhënie te kontratës, prandaj edhe po të kthehej lënda ne rivlerësim, bazuar ne kriterin e dhënies se kontratës (çmimi me i lire), rezultati mbetet i njëjtë.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues në përgjigjen e tij lidhur me rekomandimin e ekspertit deklaron se pajtohet, ndërsa OE deklaron se nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues konstaton se pretendimet ankimore të OE ankues, kundër OE të rekomanduar," Eko Term Sh.p.k" janë vërtetuar nga eksperti se OE i rekomanduar,"Eko Term Sh.p.k" në dosjen e tenderit/ ofertës, i ka të prezantuar listën e projekteve së bashku me dëshmi tjera dokumentare përmes të cilave vërtetohet se i njëjti e mbulon kërkesën kualifikuese andaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Paneli shqyrtues konstaton se i përket pretendimit tjetër ankimor, se OE i rekomanduar" Eko Term Sh.p.k" ,për dhënie te kontratës, nuk ka prezantuar dëshmi sipas natyrës së kontratës, konstatohet se Dosja e Tenderit dhe Njoftimi për Kontrate, është përcaktuar se kërkohet dëshmi për projekte të ngjashme dhe jo të njëjta, andaj dhe ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Paneli shqyrtues vlerësimin e ekspertit sa i përket pohimit OE ankues, për sigurimin e ofertës, më saktësisht periudhën prej 90 ditësh, e pranon si të mirëqene, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës OE ankues gjendet dokumenti i Sigurimit të Tenderit, me validitet nga Kompania e Sigurimeve Sigal, ne vlere prej 1,000.00 Euro, për periudhën kohore nga data 03.07.2023 deri me date 30.09.2023, andaj ky pretendim ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP gjatë vlerësimit të kësaj procedure të prokurimit.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha shkresat e lëndës , raportin e ekspertit shqyrtues, ankesën e palës, vendimet e AK, dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e "Shtruarja e dyshemesë me epoksid dhe ndërtimi i kartotekës ne objektin e ri te QKMF-së" në KK Mamushe" me nr. të prokurimit: 626-23-5792-5-2-1 , bazuar vlerësimet me mësipërme lidhur me tri pretendimet ankimore të palës, nga të cilat dy pretendime janë të pabazuara dhe një i bazuar, konstaton se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar, por që nuk ndryshon rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur ta lejë në fuqi vendimin e AK, saktësisht njoftimin për dhënie të kontratës të publikuar me datën 25. 07. 2023 nga autoriteti kontraktues, që i njëjti AK të vazhdojë me procedurën e prokurimit konform dispozitave ligjore te LPP-së lidhur me aktivitetin ne fjalë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E MAMUSHËS**
- OE - **. Limit L & B SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: